



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 3, datë 30.01.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME  
KUKËS SH.A.

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 30.01.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a.",

**Konstaton se:**

1. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a me shkresën nr.22 prot. datë 21.12.2022 si dhe me plotësimet me anë të shkresës me nr.22/1 prot. datë 30.12.2022, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Kukës sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (**VKM nr. 302**).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
- a) Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Kukës sh.a (NUIS M28322201I) është themeluar më datë 16.09.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, Bashkitë Kukës me 28.34%, Tropojë me 14.6%, Has me 6.06%.
  - b) Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 51 527 banorë të Bashkive Kukës, Tropojë, Has;
  - c) Drejtuese teknike e shoqërisë znj. Hazbije Onuzi (Gjana) është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së ndërtimit, Dega Mjedis, Profili Trajtim Uji në vitin 2016 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Kukës sh.a, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
  - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Kukës sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Kukës sh.a me (NUIS M28322201I), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;
2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Kukës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
  - a) Drejtues Ligjor – Eduard Spahia
  - b) Drejtues Teknik – Hazbije Onuzi (Gjana)
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Kukës sh.a janë Bashkitë Kukës, Tropojë, Has.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Vendimi i KKRR nr.122, datë 20.10.2020 për “Licencimin e sh.a. Ujësjellës Kanalizime Kukës”, shfuqizohet;
6. Vendimi i KKRR nr.319, datë 20.08.2021 për “Licencimin e sh.a. Ujësjellës Has”, shfuqizohet;
7. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
8. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**